

VENDIM
Nr. 869, datë 24.12.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH TË MARRËVESHJES SË GRANTIT (GRANT NR. TF017364),
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM , QË VEPRON SI AGJENCI ZBATUESE PËR
FONDIN GLOBAL TË MJEDISIT (GEF), PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE
MJEDISORE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 152/2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit (grant nr. TF017364), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si agjenci zbatuese për Fondin Global të Mjedisit (GEF), për projektin e shërbimeve mjedisore, ratifikuar me ligjin nr. 152/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Banka Botërore
IBRD ° IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE
Pratertrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020
LINDA VAN GELDER
Drejtoresha Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore

30 shtator 2019

Sh. S. Anila Denaj
Ministër e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë, Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,

Projekti i Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri
Fondi për Mjedis Global TF nr. TF017364
Zgjatje e Afatit të Mbylljes

I referohemi Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në funksionin e agjencisë zbatuese për Fondin për Mjedis Global (GEF), të datës 25 korrik, 2015 për Projektin e Shërbimeve Mjedisore (“Projekti”) dhe letrës suaj, datë 12 shtator 2019, ku Bankës Botërore i kërkohet zgjatje e afatit të mbylljes së Grantit të sipërpërmendur, nga 30 shtator 2019 deri në datën 30 shtator 2020.

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 30 shtator 2020, si datë të mëvonshme për qëllime të paragrafit IV.B.2, të skedulit 2, të Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt,
Nënshkrimi
Linda Van Gelder
Drejtoresha Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore

Në vëmendje të: SHT Blendi Klosi - ministër i Turizmit dhe Mjedisit
Z. Erjon Luci - zëvendësministër i Financave
Znj. Petra Burcher - shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim - pranë Ambasadës Suedeze
Z. Tomas Nystrom, drejtues Programi, Ambasada Suedeze
Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e
Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
Z. Patrizio Pagano, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore, SHS Anila Denaj
Miratuar nga: Kseniya Lvovsky, Manaxhere e Praktikave, GENEK - Damir Leljak (WFACS)
Për dijeni: Linda Van Gelder, Maryam Salim, Kseniya Lvovsky, Luis M.Schwarz, Damir
Leljak, Drita Dade, Silvia Mauri, Arben Maho, Jonida Myftiu, Bekim Imeri, Esma Kreso, Elona
Qana, Simon Ellis, Lada Strellkova, Goran Tinjic, Daria Lavrentieva, Valentina Martinovic,
Nejme Kotere, Evis Sulko, Luz Meza-Bartrina, Nadeem Mohammad, Albania DL, ECA
Operations, Drejtor GENEK GP, ECCWB Ekipi Manaxherial (ECCWB DMT), WB Docs.
Person kontakti: Drita Dade (numri i brendshëm 5246 137)